

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lamine Yamal intensifikon kandidaturën për Topin e Artë
ADRESA	https://albeu.com/sport/lamine-yamal-intensifikon-kandidaturen-per-topin-e-arte/1011337/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:08:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:07:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9a4173243fef850c3c30fec78f20d49d3b32f9afa871647fa38d84fcfee38bdd
TEKSTI	7590fa87618a91d2595a9e9f09ecf759e1cd6013984bd4e73c98c1f6b09274c1
PAMJA	3c092e2d31fa7840abfc8ac570148df2819f150ef41a88c711e706c175772ea7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4683ac4fe98938da35baf8b55c563390b8236c719ce437190ef06b8de9837650
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4683ac4fe98938da35baf8b55c563390b8236c719ce437190ef06b8de9837650>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lamine Yamal intensifikon kandidaturën për Topin e Artë



Kanë mbetur vetëm dy javë deri në përfundimin e votimit për Topin e Artë dhe Lamine Yamal po shfrytëzon çdo paraqitje për të bindur votuesit se e meriton trofeun prestigjioz.

Futbollisti i Barcelonës ka deklaruar se nuk do të lutet për çmimin, por njëkohësisht nuk e ka fshehur bindjen se është i denjë për ta fituar atë. Këtë qëndrim ai e ka shprehur edhe më parë publikisht, ndërsa performancat e tij në fushë po e vendosin mes pretendentëve kryesorë, pavarësisht nivelit të lartë të konkurrencës.

Klubi katalanas po zhvillon një fushatë të hapur në mbështetje të anëorit 19-vjeçar, ndonëse forma e tij aktuale duket se është argumenti më i fortë. Statistikat e ndeshjeve të fundit po konfirmojnë rolin e Yamalit si një prej futbollistëve më të spikatur në botë.

Afati i votimit për 100 gazetarët profesionistë nga vendet e renditura nga FIFA përfundon pas dy javësh, më 28 shtator. Ceremonia e Topit të Artë do të zhvillohet më 26 tetor në London Palladium.

Mes 30 finalistëve ndodhen edhe yje si Harry Kane, Jude Bellingham, Kylian Mbappé, Ousmane Dembélé, Erling Haaland, Lionel Messi, Pau Cubarsí, Marc Cucurella, Rodri Hernández, Fabián Ruiz, Bruno Fernandes dhe Ferran Torres, ndër të tjerë.

"Unë dhe Mbappé jemi dy më të mirët, por mendoj se e meritoj Topin e Artë", u shpreh lojtari i Barcelonës në një intervistë për 'Universo Valdano' të Movistar Plus.

Starti i sezonit ka qenë veçanërisht bindës për Yamalin. Në gjashtë ndeshje të luajtura, pesë në La Liga dhe një në Ligën e Kampionëve, reprezentuesi spanjoll ka realizuar 7 gola dhe ka dhënë dy asistime.

Katër ndeshjet e fundit kanë qenë edhe më produktive për të. Përballë Rayo Vallecanos, Valentias, Levantes dhe Feyenoordit, Yamal ka shënuar në secilën ndeshje, ndërsa në tri takimet e kampionatit ka realizuar nga 2

të fundit /



Lamine Yamal intensifikon kandidaturën për Topin e Artë...



Tom Holland ngjitet në vendin e parë mes aktorëve me filmat m...



Divjaka kundërshton bashkimin me Lushnjën, relacioni d...



Bekim Sejdiu heq dorë nga gara për President të Kosovës



Hamza diskuton me ambasadorin e BE-së, Dirk Schuebel,...



Gola: Pretendimet për tensione ndëretnike në Kosovë duhen...



Mbrojtjet në Hagë: Aktakuza ndaj Fazliut lidhet me dy takime,...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

gola.

Me 6 gola në La Liga, ai është aktualisht ndër emrat që udhëheqin garën për Pichichi, së bashku me Camellon, Mbappén dhe Raphinhën.

Edhe drejtuesit e Barcelonës po e shfaqin publikisht mbështetjen për kandidaturën e tij. Zëvendës-presidenti Rafa Yuste deklaroi disa orë më parë: "Shpresoj që drejtësia të vihet në vend dhe t'ia japin Lamine".

Presidenti Joan Laporta kishte bërë më herët një deklaratë në të njëjtën linjë, duke e renditur Yamalin ndër favoritët kryesorë të garës.

"Lamine është një nga favoritët e mëdhenj dhe do të doja shumë që ai ta fitonte. Ai po luan në mënyrë spektakolare. Ka cilësi të jashtëzakonshme. Është gjeni", tha Laporta.

Gjatë javëve të fundit, edhe bashkëlojtarët e tij kanë argumentuar se anëtori duhet të fitojë çmimin, duke vënë në pah paraqitjet e tij dhe ndikimin në sukseset e Barcelonës.

Vlerësimi për Topin e Artë mbështetet te paraqitjet individuale vendimtare dhe mbresëlënëse, rezultatet e ekipit dhe trofetë e fituar me klubin e përfaqësuesen, si edhe te klasi dhe loja e ndershme.

Yamal i përmbush të tria këto kriterë dhe për këtë arsye konsiderohet një prej favoritëve të mëdhenj. Deri në mbylljen e votimit, më 28 shtator, ai ka ende kohë për ta përforcuar kandidaturën dhe për të synuar vendin e parë në garën për çmimin më prestigjioz individual të futbollit.

Shtuar më 14.09.2026 19:07

Tags: [BARCELONA](#), [la liga](#), [lamine yamal](#), [Topi i Artë](#)



Arsenali reagon ashpër pas penaltisë së diskutueshme kundër Sunderlandit



VAR-i lë jashtë detyrës dy zyrtarët pas vendimit të diskutueshëm për golin e...



Dukagjini mbetet pa humbje pas barazimit pa gola me Ballkanin



Malisheva triumfon 4-0 ndaj Llapit në Podujevë



Real Madridi synon sërish Martin Zubimendin, Arsenali mund të shqyrtoj...



E zgjedhën si kandidat për mbret, por portieri i ligës së nëntë angleze zgjodhi të...



Agim Zeka rikthehet në Kosovë, firmos me Drenicën pas largimit nga...



Raphinha nuk përfshihet në garën për Topin e Artë 2026



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.